



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2374 / Prot.
1

Tiranë, më 3.7. 2020

URDHËR

Nr. 210, Datë 3.7.2020

PËR

**RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
“BACHELOR” NË “ADMINISTRIM BIZNESI” ME PROFILE “MARKETING”,
“EKONOMI BIZNESI” DHE “MENAXHIM”, NË UNIVERSITETIN E NEW YORK-UT,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 73 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

URDHËROJ:


1. Riorganizimin e programit të studimit të ciklit të parë nga “Bachelor” në “Administrim biznesi” me profil në “Administrim biznesi”, me kohëzgjatje normale 4 vite akademike (8 semestra), në program të ciklit të parë “Bachelor” në “Administrim biznesi” me profile “Marketing”, “Ekonomi biznesi” dhe “Menaxhim” në Universitetin e New York-ut, Tiranë, me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.

Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë “Bachelor” në “Administrim biznesi” me profile “Marketing”, “Ekonomi biznesi” dhe “Menaxhim”, në Fakultetin e

Ekonomisë dhe Biznesit, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, referuar nivelit 6 të Komizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Veprimtaria akademike në programin e riorganizuar të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Administrim biznesi” me profile “Marketing”, “Ekonomi biznesi” dhe “Menaxhim”, në Universitetin e New York-ut, Tiranë, fillon në vitin akademik 2020-2021.
3. Universiteti i New York-ut, Tiranë, të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Universiteti i New York-ut, Tiranë, të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Universiteti i New York-ut, Tiranë,

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Besa SHAHINI